



1. NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur.

Data	Repo një javore
07.04.2005	4,470.00
14.05.2005	6,625.00
21.04.2005	5,340.00
28.04.2005	6,980.00
05.05.2005	7,640.00
12.05.2005	7,910.00
19.05.2005	5,465.00
26.05.2005	7,852.50
02.06.2005	7,051.80
09.06.2005	7,540.00
16.06.2005	4,145.00
23.06.2005	770.00
30.06.2005	1,130.00

Situata e likuiditetit në tremujorin e dytë të vitit 2005 u karakterizua nga tepriçë likuiditeti në nivel mesatar më të ulët se tremujorin e parë të vitit. Për administrimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë ndërhyri me instrumentin kryesor të tregut (*marrëveshje riblerjeje me maturim 1 javor me çmim fiks*) në vlerë mesatare javore prej 5.61 miliardë lekësh në krahasim me 6.97 miliardë lekë gjatë tremujorit të parë të vitit.


Tabelë 1: Vëllimi i likuiditetit i tërhequr nëpërmjet operacioneve të tregut të hapur (në milionë lekë).

1.2 Përdorimi i instrumenteve mbështetëse.

Në mbështetje të ndërhyrjeve me instrumentet e tregut të hapur, për investimin e likuiditetit të lirë, bankat përdorën edhe depozitën njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës ishte 450 milionë lekë, në krahasim me 912 milionë lekë në tremujorin e kaluar. Ndërkohë që bankat u përballën me presionin për rritjen e gjendjes së lirë të likuiditetit gjatë ditëve të fundit të periudhës të

mbajtjes së rezervës të detyruar, duke kërkuar likuiditet nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet akordimit të kredisë njëditore, niveli mesatar ditor i të cilës, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005, kapi vlerën 36 milionë lekë.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë periudhës janar 2005 - qershor 2005.



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2005 Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në tregun e brendshëm valutor. Sikurse dhe në tremujorin paraardhës, nuk është regjistruar asnjë veprim shitje-blerje në valutë me bankat e nivelit të dytë.